



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1468/1 Prot.

Tiranë, më 31.05 2024

V E N D I M

Nr. 25 datë 31.05 2024

“PËR

**MIRATIMIN E FINANCIMIT TË PJESËMARRJES SË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS SI PARTNER NË KONFERENCËN E 10-TË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE TË KINEZIOLOGJISË, FAKULTETI I KINEZIOLOGJISË/UNIVERSITETI I ZAGREBIT, KROACI”**

Në zbatim të nenit 3, nenit 49, të ligjit nr.80/2015 ” Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës neni 43, në Vendimin e Senatit Akademik me nr.120 datë 14.11.2023 “Për propozimin e pjesëmarrjes së UST si partner në Konferencën e 10—të Shkencore Ndërkombëtare në Kineziologji të Fakultetit të Kineziologjisë/Universiteti i Zagrebit, Kroaci, në Vendimin e Senatit Akademik me nr.136 datë 19.12.2023 “Për nënshkrimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në Konferencën e 10-të Shkencore Ndërkombëtare në Kineziologji të Fakultetit të Kineziologjisë/Universiteti i Zagrebit, Kroaci, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 82 datë 21.12.2023 “Për pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në Konferencën e 10-të Shkencore Ndërkombëtare në Kineziologji të Fakultetit të Kineziologjisë/Universiteti i Zagrebit, Kroaci, në Vendimin e Rektoratit nr.40 datë 20.05.2024 “Për propozimin e financimit e pjesëmarrjes së Universitetit të Sporteve të Tiranës, në Konferencën e 10-të Shkencore Ndërkombëtare në Kineziologji të Fakultetit të Kineziologjisë/Universiteti i Zagrebit, Kroaci”, në Vendimin e Senatit Akademik nr.41 datë 28.05.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 31.05.2024,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë mbështetjen financiare për pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në Konferencën e 10-të Shkencore Ndërkombëtare të Kineziologjisë, e cila do të organizohet nga Fakulteti i Kineziologjisë, Universiteti i Zagrebit, Kroaci në datat **12-15 shtator 2024** në Opatija, Kroaci.

2. Mbështetja financiare të përfshijë :

-Mbulimin e të gjitha shpenzimeve të pjesëmarrjes së delegacionit vendosur nga Rektorati i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

-Mbulimin e shpenzimeve të tarifës së pjesëmarrësve, akomodimit dhe transportit për stafin akademik dhe atë kërkimor-shkencor të cilët do të referojnë punimet e tyre shkencore. (Një autor për një punim).

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Zhvillimit të Programve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.

4. Ngarkohet për publikim në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek Transparenca Universitare, Drejtoria e Zhvillimit të Programve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**ARTUR ÇOBANI**

